

VAZHDIMI I SHKOLLIMIT PRINDËRIT & PËRKUJDESËSIT E PORSAARDHUR PRINDËRIT U NDIHMOJNË TË RINJVE TË RUHEN, TË JENË TË LUMTUR DHE TË MËSOJNË



FILLIMI I SHKOLLES SE MESME – KËSHILLAT KRYESORE PËR PRINDËRIT DHE PËRKUJDESËSIT E PORSAARDHUR

ÇFARË ËSHTË SHKOLLA E MESME?

- Fëmijët në Mbretërinë e Bashkuar ndjekin shkollën e mesme prej moshës 11 deri në atë 16-vjeçare.
- Në shkollë të mesme, fëmijët mësojnë që të marrin në fund kualifikimet e quajtura GCSE.
- Nxënësit zakonisht duhet të veshin uniformë të veçantë me ngjyrat e shkollës.
- Përfshirja në shkollën e mesme, vendosja e rutinës së përditshme dhe lidhja e miqësive ndikojnë të gjithat së bashku që fëmijët e refugjatëve të integrohen në jetën e tyre të re në Mbretërinë e Bashkuar dhe të ndihen të sigurt dhe të vendosur.
- Pavarësisht vendit të prejardhjes së tyre, fesë, besimit ose përvojave të mëhershme, shkolla e mesme është e përkushtuar që të ofrojë arsim të cilësisë së lartë dhe përvojë pozitive për çdo fëmijë.
- Ky është rast i mirë për fëmijën tuaj që të mësojë aftësi të reja dhe të gjejë shokë të rinj.

SI TË NDIHMOHET FËMIJA QË TË SISTEMOHET

Shkolla do të bëjë çmos për t'u ndihmuar familjeve dhe fëmijëve të refugjatëve që të sistemohen dhe të ndihen mirë.

- Kur një fëmijë refugjat ta nisë shkollën, e gjithë shkolla nxitet që të festojë kulturën dhe gjuhën e ardhacakut të ri për t'i ndihmuar atij të ndihet si në shtëpi.
- Ka shkolla që ofrojnë pako mirëseardhjeje për familjet e refugjatëve, të cilat janë të përpiluara në gjuhën e tyre amtare.
- Fëmijëve të refugjatëve mund t'u caktohet një 'shoqërues' kur të hyjnë në shkollë. Është fjala për një nxënës tjetër i cili do t'i ndihmojë atyreve që të orientohen, të sistemohen dhe të lidhin shoqëri të reja.
- Shkolla i nxit lidhjet me fëmijët nga vendi i njëjtë.
- Fjalorët dygjuhësorë zakonisht ofrohen për t'u ndihmuar nxënësve dhe mësuesve që ta kuptojnë njëri-tjetrin.
- Fëmijët do të përkrahen që ndjenjat e tyre t'i shprehin nëpërmjet artit, krijimtarisë letrare ose teatrit.

MËSIMI I ANGLISHTES

Gjatë shkollës së mesme, fëmija juaj do të përkrahet që të mësojë anglisht.

Fillimisht ai ose ajo vetëm do t'i dëgjojë mësuesit dhe nxënësit e tjerë duke folur, derisa të fillojnë që t'i mësojnë tingujt dhe fjalët e reja. Kompjuterët mund të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive gjuhësore.

Fëmijët e refugjatëve do të përkrahen që të vazhdojnë të flasin në gjuhën e vet amtare përderisa ta mësojnë anglishten. Kjo u ndihmon atyreve që ta mbajnë mend identitetin e vet. Shumë biblioteka lokale mbajnë libra në gjuhë të tjera. Ka mundësi që aty mund të huazoni libra për ju dhe për fëmijën tuaj dhe t'i lexoni ato së bashku në gjuhën tuaj amtare.

SHKOLLAT JANË EDHE PËR PRINDËRIT!

- Shkollat e mesme në Mbretërinë e Bashkuar i përkrahen prindërit në mënyrë aktive që të përfshihen në jetën shkollore. Juve ju takon që të luani rol pozitiv në shkollimin e fëmijës tuaj.
- Do t'ju ftojë rregullisht në shkollë për t'i takuar mësuesit dhe prindërit e tjerë. Shkollat organizojnë ekspozita, festa sportive dhe mbrëmje për prindër në të cilat familjet mund të vijnë në shkollë. Nëse ka nevojë gjithmonë do të sigurohen edhe përkthyesit me shkrim dhe me gojë.
- Në çdo kohë mund të caktoni një takim për të biseduar me një mësues ose me ndonjë të punësuar tjetër.
- Njëpërmjet letrave dhe certifikatave, të cilat në rast nevojë do të përkthehen, ju do ta merrni vesh se si është duke përparuar fëmija juaj me mësim. Madje mund t'ju ftojë që të merrni pjesë në mbledhjet e shkollës për të ndihmuar në manifestime të veçanta.
- Shpesh shkollat kanë dhoma të veçanta ku mund të takohen prindërit. Gjithashtu mund të organizohen mëngjese me kafe për prindërit ose manifestime enkas për t'u takuar familjet e refugjatëve me njëra-tjetrën.

SHKOLLA DHE KOMUNITETI MË I GJERË

Nëpunësit e shkollës do t'ju vendosin në kontakt me shërbimet lokale dhe me organizatat e refugjatëve që mund t'ju ndihmojnë lidhur me:

- Çështjet banesore
- Gjetjen e punës
- Marrjen e ndihmave sociale
- Çështjet juridike dhe të imigrimit
- Ndihmë për mësimin e anglishtes
- Përkujdesjen shëndetësore dhe gjetjen e mjekut shtëpiak
- Klubet lokale të rinisë
- Projektet rreth pushimeve
- Veprimtaritë sportive
- Grupet e grave
- Manifestimet kulturore

Për informata dhe këshilla të mëtejme:

Refugee Action – Telefoni: 020 7654 7700 Faqja në Internet: www.refugee-action.org.uk

The Refugee Council – Telefoni: 020 7346 6777 Faqja në Internet: www.refugeecouncil.org.uk

Department of Education and Skills – Faqja në Internet: www.dfes.gov.uk

Help with GCSEs – Faqja në Internet: www.bbc.co.uk/schools/gcsebitesize, www.gcse.com

Parentline (ndihma e përgjithshme) – Telefoni: 020 800 2222

Faqja në Internet: www.parentlineplus.org.uk

Ju lutemi shënojinë në vazhdim njoftimet lokale dhe mundësitë e kontaktimit

Të gjitha të drejtat e rezervuara © Crown, gusht 2006.